

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data : 01.03.2016]

Për: Operatorin ekonomik “Arifaj” sh.p.k me NIPT J76418907K.

Procedura e prokurimit: **“Procedurë e hapur”** me objekt : **“Rehabilitimi i rrugës Transballkanike Fazat 1 dhe 2 (lidhja e rrugës Transballkanike me autostradën Fier - Vlorë) si dhe kryerja e punimeve për sistemimin e ndricimit, gjelbërimit dhe trotuareve në rrugën Transballkanike Vlorë”.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Rehabilitimi i rrugës Transballkanike Fazat 1 dhe 2 (lidhja e rrugës Transballkanike me autostradën Fier - Vlorë) si dhe kryerja e punimeve për sistemimin e ndricimit, gjelbërimit dhe trotuareve në rrugën Transballkanike Vlorë”.**

Kohëzgjatja: **brënda 190 ditësh kalendarike nga data e fillimit te punimeve.**

Fondi limit: **136.249.323 (njëqind e tridhjetë e gjashtë milion e dyqind e dyzet e nëntë mijë e treqind e njëzet e tre) lekë pa tvsh.**

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Date 05.01.2016.**

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Nuk ka patur.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

NR	SHOQERIA	OFERTA PA TVSH
1	B-93	91,591,814
2	RIVIERA	98,079,800
3	SHKELQIMI 07	101,437,850
4	ARIFAJ	118,082,369
5	BE - IS SH.P.K	124,948,506
6	CAUSHI/M	NUK KA PARAQITUR OFERTE

Jane skualifikuar ofertuesit e meposhtem:

1. **“Riviera” shpk per arsye se:**

Nuk ploteson kerkesen per kualifikim lidhur me detyrimet fiskale pasi ka detyrime ne shumen 6.900.924. Per kete detyrim ka lidhur marreveshje me organet tatimore.

Nuk ploteson piken 2.1e te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim pasi mungon vertetimi per shlyerjen e detyrimeve ndaj OSHEE per muajin Nentor 2015 (detyrim ky i maturuar ne daten 04 Janar 2016, dita e tenderit).

Nuk ploteson piken 2.4.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim *”Operatori Ekonomik duhet te kete realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50% e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se 200% e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit”* pasi vlera totale e punëve te kryera ne tre vitet e fundit, referuar faturave te paraqitura, eshte 18.810.014 leke pa tvsh.

Nuk ploteson piken 2.4.7 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim *”Makinerite e mesiperme nuk duhet te jene te angazhuara ne kontrata te tjera. Per kete te paraqitet nje deklarate nga administratori i shoqerise ofertuese se makinerite e mesiperme nuk jane te angazhuara ne kontrata te tjera dhe nuk jane deklaruar ne nje procedure tjetere tenderimi ne te cilen nuk eshte shpallur ende fituesi”* pasi nuk e ka paraqitur deklaraten e kerkuar.

2. “Shkelqimi-07” shpk (45,4%), “SMO Union” shpk (35,3% dhe “Grand Konstruksion M” shpk (19,3%) per arsye se:

Shoqeria “Shkelqimi-07” shpk nuk ploteson piken 2 te Kerkesave te Pergjithshme per Kualifikim pasi ka detyrim per kontributet e sigurimeve shoqerore e shendetesore ne shumen 1.500.000 leke dhe eshte ne proces apelimi.

Shoqeria “Grand Konstruksion M” shpk nuk ploteson piken 2.4.5 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim *”Operatoret ekonomike duhet te disponojne licensat e nevojshme per zbatimin e kontrates. Per kete duhet te paraqesin licensen perkatese te shoqerise,..”* pasi nuk disponon piken e licenses NS 18 – Punime Topogjeodezike, e domosdoshme per realizimin e punimeve qe ka marre persiper.

Shoqeria “Grand Konstruksion M” shpk nuk ploteson piken 2.4.6 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim *”Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet dhe paisjet teknike ...”* pasi disponon vetem nje kamion dhe nje minieskavator, nderkohe qe ka marre persiper te realizoje shtrese cakelli, shtrese stabilizanti, shtrese binderi dhe shtrese asfaltbetoni per te cilat nuk disponon asnje mjet.

3. “Caushi/M” shpk per arsye se: Nuk ka paraqitur oferte.

4. “B-93” shpk (60%) dhe “Ndrekaj” shpk (40%) per arsye se: nuk paraqiti argumentime per oferten anomalisht te ulet.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “Arifaj” sh.p.k (NIPT J76418907K) se oferta e paraqitur, me vlerë **118,082,369** (njeqind e tetembedhete milion e tetedhete e dy mije e treqind e gjashtedhete e nente) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **08.02.2015**.

Në datën 11.12.2015 ka paraqitur ankesë shoqëria “Sardo” shpk ne lidhje me kerkesat per kualifikim. Ankesës ju kthye përgjigje në datën 14.12.2015.

Në datën 17.12.2015 ka paraqitur ankesë shoqëria “Kevin Konstruksion” shpk” shpk ne lidhje me kerkesat per kualifikim. Ankesës ju kthye përgjigje në datën 21.12.2015 duke e refuzuar ate.

Ne daten 15.02.2016 paraqiti ankese bashkimi i perkohshem i shoqerive “Shkelqimi-07” shpk & “SMO Union” shpk & “Grand Konstruksion M” shpk lidhur me vleresimin. Ankesës ju kthye përgjigje në datën 19.02.2016 duke e refuzuar ate.

